

L I G J
Nr.8071, datë 15.2.1996

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7958, DATË 5.7.1995 “PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR.7745, DATË 26.7.1993 “PËR RIVLERËSIMIN DHE RISHPËRNDARJEN NË VLERË TË PASURISË SË ISH-KOOPERATIVAVE BUJQËSORE”

Në mbështetje të neneve 16 e 17 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 1, pika 3 e ligjit nr.7958, datë 5.7.1995 “Për disa shtesa në ligjin nr.7745, datë 26.7.1993 “Për rivlerësimin dhe rishpërndarjen në vlerë të pasurisë së ish-kooperativave bujqësore”, fjalia "vjelja dhe rishpërndarja realizohet brenda muajit shtator 1995" zëvendësohet me fjalinë: “Vjelja dhe rishpërndarja realizohet deri më 1 shtator 1996. Shumat e arkëtuara deri tani nga kamatëvonesat u kthehen personave përkatës”.

Pas paragrafit të parë të pikës 3 të nenit 1 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Likuidimi i detyrimeve financiare nga personat juridikë a fizikë që kanë blerë objekte të pasurisë së patundshme të ish-kooperativave bujqësore të bëhet brenda afatit të përcaktuar në paragrafin e parë të kësaj pike. Pas këtij afati këshilli i komunës ka të drejtë që këtë pasuri ta shesë në ankand për llogari të rivlerësimit e rishpërndarjes në vlerë të pasurisë së ish-kooperativave bujqësore”.

"Të ardhurat e realizuara nga vjelja e 0.5 përqindëshit për çdo ditë vonesë të shlyerjes së detyrimit nga debitorët, përdoren nga komuna për ndërtim, rregullim e mirëmbajtje të infrastrukturës (rrugë, ura, shkolla, qendra shëndetësore apo kulture), si dhe për shlyerjen e detyrimit ndaj zyrave të përbarimit në zbatim të këtij ligji”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi më 15.2.1996.

Shpallur me dekretin nr.1392, datë 5.3.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha